



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Shkolla (Akademia) e Administratës Arsimore

NUMËR: MASHT[I] 17/2005

DATË: 28.04.2005

Në pajtim me nenin 1.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë (IPVK), nenit 6.1 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në vijim MASHT) përmes këtij Udhëzimi Administrativ (më tutje UA) rregullon çështjen në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Përcaktimi i procedurave të themelimit të Shkollës (**Akademisë**) së Administratës Arsimore (në vijim shkolla), strukturën organizative, fushëveprimtarinë, financimin dhe mbikëqyrjen e saj me qëllim të rritjes së efikasitetit në procesin e organizimit, zbatimit dhe kontrollimit të zhvillimeve profesionale në institucionet arsimore dhe jetësimin më racional të strategjisë dhe politikave të MASHT në zbatimin e reformave të sistemit të arsimit në Kosovë.

Neni 2

Themelimi

Shkolla e Administratës Arsimore themelohet dhe rregullohet fushëveprimtaria e saj me aktin e nënshkrimit të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 3

Statusi i shkollës

3.1. Shkolla është institucion publik arsimor i nivelit 4 ose 5 (sipas ISCED) që themelohet nga MASHT dhe punon nën patronatin e saj (MASHT). Shkolla për punën e saj i përgjigjet MASHT, ndërsa në aspektin e veprimtarisë akademike i përgjigjet këshillit mësimor dhe këshillit mbikëqyrës.

3.2. Shkolla funksionon sipas akteve të përgjithshme ligjore të nxjerra nga MASHT dhe institucionet tjera kompetente të Kosovës si dhe akteve specifike, statutit dhe rregulloreve tjera të punës.

3.2. Statutin e përgatit këshilli mësimor dhe i propozon MASHT – it për miratim, ndërsa rregulloret e shkollës miratohen nga Këshilli mbikëqyrës.

Neni 4

Struktura organizative

Shkolla ndërtohet prej katër komponenteve organizative: komponentës administrative, komponentës profesionale, këshillit mësimor dhe këshillit mbikëqyrës. Përshkrimi i ndërtimit të këtyre komponenteve bëhet me statut të shkollës.

4.1. Komponenta administrative ka në përbërje:

- a. drejtorin
- b. zyrtarin administrativ
- c. zyrtarin financiar
- d. zyrtarin prokurues
- e. punëtorin teknik dhe të higjienës (varësisht nga sipërfaqja e objektit)

4.2. Komponenta profesionale ka në përbërje:

- a. tre ligjerues të rregullt (fillimisht)
- b. ligjerues me korrespondencë
- c. një ekspert për programe dhe mjete mësimore
- d. një ekspert për teknologji informative

4.3. Këshilli mësimor përbëhet prej pesë anëtarëve: drejtorit të shkollës, një ligjeruesi të rregullt, një zyrtari të lartë të MASHT, një përfaqësuesi të Universitetit të Prishtinës dhe një drejtori të shkollës së mesme të lartë apo i arsimit të obligueshëm. Këshilli mund të ketë edhe një anëtar pa të drejtë vote nga radhët e partnerëve të shkollës. Roli i këshillit mësimor përcaktohet me statut të shkollës.

4.4. Këshilli mbikëqyrës

Mbarëvajtja e veprimtarisë së shkollës sigurohet nëpërmjet një këshilli mbikëqyrës i përbërë prej pesë anëtarëve. Tre anëtarë emrohen nga shkolla, ndërsa dy anëtarë emërohen nga MASHT. Detyrat e punës dhe mënyra e marrjes së vendimeve përcaktohen me statutin e shkollës.

Neni 5

Pranimi i punëtorëve

Mënyra e pranimi të punëtorëve në shkollë bëhet sipas Ligjit mbi shërbimin civil në Kosovë, ndërsa përshkrimi i detyrave të punës për secilin vend të punës përcaktohet me statut të shkollës.

Neni 6

Drejtori dhe personeli administrativ

Drejtori zgjedhet nga MASHT-i dhe i përgjigjet MASHT-it, ndërsa personeli tjetër administrativ nga vet shkolla në përputhje me rregullativën ligjore.

Neni 7

Personeli akademik

Personeli akademik pranohet nga këshilli mësimor, pas shpalljes publike të vendeve të lira.

Neni 8

Fushëveprimtaria e shkollës

8.1. Veprimtaria themelore e shkollës konsiston në ngritjen e kapaciteteve profesionale të udhëheqësëve dhe personelit administrativ të institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në fushat përkatëse.

8.2. Ngritja e kapaciteteve profesionale të udhëheqjes arsimore dhe personelit administrativ bëhet nëpërmjet një programi mësimor të akredituar i përbërë prej tri llojeve të kurseve të fushave përkatëse:

- a. kurse themelore (bazike)
- b. kurse të mesme të avansuara dhe
- c. kurse të larta të avansuara

8.3. Mënyra e organizimit të kurseve dhe numri i krediteve sipas nivelit të kurseve të fushave përkatëse dhe llojeve të grupeve të shkollimit përcaktohet me statut të shkollës.

Neni 9

Bashkëpunimi

9.1. Shkolla mund të nënshkruaj dokumente të bashkëpunimit dhe të partneritetit me persona fisik dhe juridik si dhe me institucione relevante arsimore e administrative me qëllim të ngritjes së cilësisë së veprimtarisë së shkollës.

9.2. Shkolla në fillim të punës së saj mund, nëpërmjet një marrëveshjeje, të angazhojë një institucion arsimor relevant vendor apo ndërkombëtar për zhvillimin e procesit mësimor.

Neni 10

Përfituesit

Përfitues të kësaj shkolle janë: drejtorët e shkollave, personeli administrativ i shkollës dhe i DKA, tërë personeli i ZRA, inspektorët e arsimit, strukturat udhëheqëse të MASHT dhe strukturat udhëheqëse të arsimit të lartë.

Neni 11

Çertifikimi

11.1. Të gjithë vijuesit e kësaj shkolle pas çdo kursi do të i nënshtrohen një vlersimi adekuat për shkallën e arritshmërisë.

11.2. Vijuesit e kësaj shkolle pas përfundimit me sukses të kurseve përkatëse do të marrin certifikatë me anë të cilës do të tregohet shkalla kualifikuese e vijuesit.

Neni 12

Akreditimi

12.1. Shkolla fillimisht do të akreditohet nga MASHT, ndërsa së paku pas çdo katër vjetëve shkolla do të i nënshtrohet një vlerësimi të jashtëm që do ta bëjë Agjencia e Akreditimit të Kosovës.

12.2. Nëse me rastin e vlerësimit konstatohet se shkolla nuk është e suksesëshme apo fushëveprimtaria e saj nuk i arrinë objektivat për çka është themeluar, MASHT do të pezullojë primtarinë e saj deri në momentin kur AAK do të vlerësoj pozitivisht kërkesën e saj për rilicensim.

Neni 13

Financimi

13.1. Shkolla është institucion publik dhe financohet nga Buxheti i Konsileduar i Kosovës nëpërmjet MASHT si dhe nga të hyrat vetanake të cilat do të gjenerohen nga participimi i vjesëve të shkollës.

13.2. Lartësia e participimit do të përcaktohet me një udhëzim të veçant për të hyrat vetanake të shkollës.

13.3. Shkolla është e obliguar ta bëjë planifikimin e buxhetit në përputhje me planin e veprimit të shkollës dhe t'i propozojë MASHT miratimin e tij.

13.4. Shkolla mund të pranojë të hyra materiale apo konsulencë profesionale edhe nga donatorë dhe investues të ndryshëm të huaj dhe vendorë.

13.5. Shkolla është e obliguar që të bëjë udhëheqjen e buxhetit në bazë të Ligjit për menagjimin e financave publike dhe akteve tjera nënligjore. Drejtori i shkollës është aprovues i buxhetit.

13.6. Zyra e auditimit bënë kontrollë të rregullt për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e shkollës dhe i raporton Sekretarit të përhershëm për këtë.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim Administrativ hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Agim Veliu, Ministër